



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SELENICË  
NJESIA E PROKURIMIT**

**PROCESVERBAL**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:** Permiresimi I banesave egzistuese per komunitetet e varfera dhe te pafavorizuara loti 1

**VLERA E FONDIT LIMIT:** 10.029.515Dhjetemiljon e njezete e nentemije e peseqind e psembdhjete

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Seleniceka** hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë

**KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 8

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

**2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

*Sipas shtojcës 8*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" si dhe nenit

*Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST*

## **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.12.2.1.** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare, **2019, 2020 dhe 2021**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit që prokurohet.

**2.2.2.** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2019, 2020 dhe 2021**, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar" i ndryshuar.

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk kanë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

**2.2.3.** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin **2021 dhe 2022** duke mbajtur në konsideratë edhe përcaktimet e Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitet e vetëqeverisjes vendore, prane njesive vendore ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin sipas regjistrimit në QKB (Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë secili anëtar i bashkimit duhet të paraqesë vërtetimin

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Referuar fondit limit sipas nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar legjislacionin tatumor

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, legjislacionit tatimor.

## **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

**2.3.1.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

**Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme**

a) punë të ngjashme **për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50%** e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar **gjatë pesë viteve të fundit**, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, **ku vlera monetare totale e punëve të kryera**, e marrë së bashku gjatë **pesë viteve të fundit**, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

**Plotesimi i njerit prej dy kushteve te siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme.**

***Pika 2.3.1 germa a)** plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.. Në rastin kur operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesmarje në bashkim, vendosin me marveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të permbushë këtë kusht.*

*Kurse pika 2.3.1 germa /b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit **në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.** (Neni 88, pika 3, i VKM-se nr.285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”).*

**Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:**

a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
- Kontratë Sipërmarrje
- Situacionin përfundimtar;
- Aktin e kolaudimit;
- Certificate marrje ne dorezim

**Shënim:** *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Vertetim lëshuar nga subjekti privat shoqëruar me:
- Kontrate Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Akt kolaudim i objekti;

**Shënim:** Vertetimi duhet të percaktoje saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Referuar fondit limit sipas nenin 39, pika 5 ”Kërkesa të vecanta për kontratat për punë publike”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

---

**2.3.2.** Operatorët ekonomike duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas formatit të miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008, ”Per miratimin e rregullores per kriteret dhe Procedurat e dhenies se licencave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te Subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi”. Shqyrtimi i licencave do të behet mbi bazen e rregullave të parashikuara sa me sipër. Licenca profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontrates duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

#### ***PUNIME TE PERGJITHSHME NDERTIMI***

- NP-1 A
- NP-7 A

#### ***PUNIME SPECIALE NDERTIMI***

##### ***NS-1A***

- NS-8 A
- NS-9 A
- NS- 4A

*Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastruktures dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të*

*zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, e miratuar me VKM- ne, Nr.42, date 16.01.2008). Mosparaqitja ne kete forme eshte kusht skualifikues.*

2. **Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendim nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores, për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

*a-Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin çertifikatat e cilësisë së punimeve, të vlefshme (ose ekuivalente) per objektin qe prokurohet, si me poshte :*

*ISO 9001:2015           Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë*

*OHSAS 18001-2007 ose ISO 45001-2018   Menaxhimi i Shëndetit dhe Sigurisë në Punë*

*Të gjitha çertifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë çertifikatën e mësipërme sipas zërave të punimeve që do të realizojë*

**Argumentimi:** Kerkesat e mesiperme jane vendosur bazuar ne Nenin 79, pika 1 te Ligjit Nr. 162/2020, “Per prokurimin publik”, sipas të cilit: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe ne zbatim te Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”

**2.3.4** - Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë fuqi punëtore mesatarisht **30 punonjes** Si dëshmi për fuqinë punëtore do të dorëzohen dokumentet si më poshtë;

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën **Janar 2022-Qershor 2022**
- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën **Janar 2022-Qershor 2022**

**2.3.5**-Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë**, si më poshtë:

- 1 (nje) Inxhinier Ndërtimi
- 1 (një) Inxhinier Gjeodet
- 1 (një) Inxhinier Hidroteknik
- 

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

*Për secilin pjestar te stafit teknik te mesiperm duhet te paraqese, Kontrate pune e vlefshme, diplome , Libreze pune dhe CV (Drejtuesit teknik te jene te siguruar sipas legjislacionit ne fuqi për periudhën **Janar 2022-Qershor 2022***

***Shënim: Në fazën e dytë operatori ekonomik duhet te deklaroje me shkrim se inxhinieret e kerkuar ne piken 2.3.5 jane te paangazhuar ne kontrata te tjera***

**2.3.6.**Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

*Për secilin pjestar te stafit teknik te mesiperm duhet te paraqese, Kontrate pune e vlefshme, diplome , Libreze pune dhe CV (Stafi mbeshtetes te jene te siguruar sipas legjislacionit ne fuqi për periudhën dhe duhet te figuroj ne listpagesat e shoqerise per periudhen **Janar 2022-Qershor 2022.***

**2.3.7** Operatori ekonomik ofertues duhet disponoje punonjës të specializuar/ kualifikuar dhe duhet te figuroj ne listpagesat e shoqerise per periudhen **Janar 2022-Qershor 2022** si më poshtë:

- Operatorët ekonomik të kenë në stafin e tyre **1 (një)** inxhinier të pajisur me çertifikatë “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M-së Nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”. Për këtë duhet të paraqitet çertifikata e trajnimit për “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit për punë”, e dhënë nga një organizem i licensuar, shqiptar ose i huaj.

- Operatorët ekonomik të kenë në stafin e tyre **1 (një)** inxhinier të pajisur me çertifikatë për “*Auditues Energjie*”. Për këtë duhet të paraqitet çertifikata e trajnimit e dhënë nga një organizem i licensuar, shqiptar ose i huaj dhe kontrate pune.

**2.3.8-** Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm: diplome, libreze pune dhe kontrate pune të vlefshme

**2.3.9-** Operatori Ekonomik duhet të disponojë Staf Mbeshtetës si më poshtë i cili duhet të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën **Janar 2022-Qershor 2022**.

- 1 (një) Teknik i mesëm Ndërtimi (Diplome e shkolles mesme)
- 4 (kater) Karpentier (Me Certifikate Trajnimi / Diplome)
- 2 (dy) Hidraulik (Me Certifikate Trajnimi / Diplome)
- 2 (dy) Hekurkthyes (Me Certifikate Trajnimi / Diplome)

Për profesionet si më sipër, operatori ekonomik duhet të plotësojë tabelën si më poshtë:

Nr.	Emer Mbiemer i punonjesit	Profesioni	Institucioni publik/privat leshues i certifikates/diplomes	Nr NIPT (Ne rast se leshuesi është institucion privat)
1				
2				
.....				

\* Në lidhje me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë dokumentacionin që verteton profesionin si :

- Kontratat e punës individuale të vlefshme.
- Për stafin e mesipër, Dëshmia e kualifikimit/ certifikate dhe/ose diploma duhet të jenë të leshuara nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr. 15/2017 “*Per arsimin dhe formimin profesional ne R.Sh.*”, i ndryshuar. Kjo kërkesë po ashtu është në përputhje me vendimin nr. 441/2020, datë 09.10.2020 të Komisionit të Prokurimit Publik. Diplomat/certifikatat e paraqitura nga organizma të cilat nuk janë të licencuara sipas legjislacionit në fuqi do të konsiderohen si dokumenta të rreme të cilat përbejnë shkak për skualifikim dhe/ose përjashtimin e këtij kontraktori nga pjesëmarrja në prokurimet publike.

**2.3.6** Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar minimumi **2 (dy)** manovratore me DAP, **2 (dy)** Automaknist me DAP, **2 (dy)** shofer kamionash, të cilët duhet të figurojnë në listëpagesa të shoqërisë të punësuar për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.4, **ose kur automjeti është me qira nuk është kusht në listëpagesën e shoqërisë , shoferi i automjetit**

- Kontratë pune të vlefshme.
  - Dëshmi kualifikimi nga organet përkatëse sipas ligjit të transportit rrugor.
- Te paraqiten ne listepagesat perkatese minimalisht Janar 2022-Qershor 2022

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve të ndërtimit dhe mekanik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit. Inxhinier Ndertimi i pajisur me certifikate per ndihmen e pare dhe nderhyrjen ndaj emergjencave është përgjegjës për sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.

Konkretisht:

**Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit të punimeve.**

- Inxhinieri i Ndërtimit është i nevojshëm për punimet për strukturat monolite prej betoni, për muret, pusetat, kanalin, vepren e marrjes. Inxhinieri i ndërtimit do te jete pergjegjes per kontrollin e cilesise te te gjithë betonit. Materialet dhe mjeshteria e perdorur ne punimet e betonit duhet te jete e nje cilesie sa me te larte qe te jete e mundur, prandaj vetem personel me eksperience dhe aftesi te plote ne kete kategori punimesh do te punohesohet per punen qe perfshin ky seksion specifikimesh.
- 
- Inxhinieri Hidroteknik është i nevojshëm për punimet e brendeshme te ndertimit tualete e lidhje te ujrave te brendeshme , si dhe gjithë punimet e tjera me karakter hidroteknik.
- Inxhinier Gjeodet ose topograf është kërkuar për arsye të zbatimit të punimeve topografike që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë dhe punimeve topogjeodezike në objekt,
- Inxhinieri i Ndërtimit i pajisur me certifikate per ndihmen e pare dhe nderhyrjen ndaj emergjencave është i nevojshëm për ndihmen e pare dhe nderhyrjen ndaj emergjencave.
- Tekniku i Ndertimit eshte i nevojshem per organizimin e grupeve te punes e makinerive ne kantier per rritjen e eficenses dhe zbatimin e punimeve sipas afatit kohor te kerkuar nga investitori.



- Manovratori është i nevojshëm për drejtimin e mjeteve të rënda, duke qene se behet fjale per ndertimin e nje kanali vadites ne te cilin uji leviz me veterrjedhje dhe realizimi i kuotave te projekti eshte tejet i rendesishem per funksionimin e vepres, cka e ben te domosdoshem perdorimin e mjeteve te germimit nga personel i kualifikuar.
  - etj.
- a. Operatori ekonomik pjesemarres, per realizimin e punimeve objekt kontrate duhet te disponoje fuqi punetore prej **minimalisht 30 persona**. Per permbushjen e ketij kriteri, duhet te paraqitet listpagesa sipas formuleve standart per sigurimet dhe vertetim, per tre muajt e fundit, te cilit i takojne pagesat me daten e hapjes se ofertes. Dokumenta te konfirmuara nga institucioni perkates sipas legjislacionit ne fuqi (*nepermjet formes elektronike*).

**Argumentim:** Autoriteti Kontraktor këtë kriter e ka bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” në të cilin thuhet: “Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”. Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në afatin, orët e punës dhe pagën minimale të lejuar, që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje tre muajt e fundit, tregon besueshmëri për autoritetin. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për një punësim të paktën 30 persona duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet. Po t’i referohemi projektit, preventivit, relacionit, matjeve përkatëse që ka bërë projektuesi është plotësisht i justifikuar numri i punonjësve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t’i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Analizat teknike janë bazuar në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018). Bazuar në këto elemente të strukturës së kostos (material, puntori, makineri, transport) zeri i fuqisë punëtore është rreth 20% të kostos.

**2.3.10** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

<i>Nr</i>	<i>Lloji i Makinerive</i>	<i>Statusi</i>	<i>Sasia</i>
2	Kamion me kapacitet mbajtes minimalisht 10-12 Ton	2 Cope	Pronësi ose me qera
4	Kamion me kapacitet mbajtes 3.5-5 ton	2 copë	Pronësi ose me qera
5	Kamion me vinc 6-10 ton	1 copë	Pronësi ose me qera
6	Fadrome kove para - mbrapa	1 copë	Pronësi ose me qera
7	Rimorkiator mbi 16 Ton	1 copë	Pronësi ose me qera
9	Eskavator me goma me targa	1 copë	Pronësi ose me qera
10	Minieskavator	1 copë	Pronësi ose me qera
11	Autobetoniere	3 copë	Pronësi ose me qera
12	Autopompe betoni	1 cope	Pronësi ose me qera
14	Autobot uji	1 cope	Pronësi ose me qera
19	Gjenerator 50 kva	1 cope	Pronësi ose me qera
20	Kontenier stacioner levizes	1 cope	Pronësi ose me qera
21	<i>Depozite uji 5000l</i>	1 cope	Pronësi ose me qera
22	<i>Pompa Uji</i>	2 copë	Pronësi ose me qera
23	<i>Tranxhe per prerjen e kthimin e hekurit</i>	2 copë	Pronësi ose me qera
25	<i>Armatura druri (betoforma/lend drusore )</i>	<i>1000 m2</i>	Pronësi ose me qera
26	<i>Vibrator betoni</i>	3 copë	Pronësi ose me qera

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet ; -leja e qarkullimit; -çertifikatën e kontrollit teknik; siguracionin; certifikatë transporti, fotot perkatese ku te duket qarte targa;
- Ndersa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mesiperm, duhet të paraqitet edhe kontrata noteriale e qirase, -leja e qarkullimit; -çertifikatën e kontrollit teknik; siguracionin; certifikatë transporti me trete dhe me qera ose në emer të kompanisë qera marrese, fotot perkatese ku te duket qarte targa.
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore perkatese, fotot ku te duket qarte dhe shërbimi i tij, ndersa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mesiperm, duhet të paraqitet edhe kontrata noteriale e qirase, e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në perfundimin e plote të punimeve

-Për impiantin e prodhimit të inerteve dhe prodhimit të betonit të paraqiten dokumentat e pronësise ose kontratën e qerasë/kontrata e furnizimit shoqeruar me leje mjedisore të leshuar nga QKL si mëposhte :

- QKL - Leje Mjedisore të tipit B, Kodi: III.1.B "Për impiant betoni, prodhimin e produkteve të betonit, shoqeruar me planvendosjen për impiantin.

- QKL - Leje Mjedisi te tipit B, Kodi: III.1.B "Per impiant inertesh, shoqeruar me planvendosjen per Impiantin dhe leje shfrytezimi.

Makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera. Për këtë të paraqitet një deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese se makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë deklaruar në një procedurë tjetër tenderimi në të cilën nuk është shpallur ende fituesi.

*Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës bazuar në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre" (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018), gjithashtu referuar edhe preventivit dhe relacionit teknik për proceset e punimeve të kërkuara për tu realizuar janë llogaritur nevojat për mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

*a. Grafiku i punimeve, për afatin prej 180 ditësh të kërkuar në DST.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik"; nenin 39, pika 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".